

VENDIM
Nr. 656, datë 10.11.2017

**PËR MIRATIMIN, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE, TË SPITALIT
UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK “KOÇO GLIOZHENI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinologjik “Koço Gliozheni”, si strukturë shëndetësore universitare e profilizuar, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si pjesë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2. Mënyra e funksionimit të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, si strukturë shëndetësore universitare, përcaktohet në statutin e tij, i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Departamentet përkatëse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti, propozojnë fushat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Spitali Universitar Obstetrik Gjinologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Në vendimin nr. 70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e spitaleve universitare”, të ndryshuar, të gjitha dispozitat që i referohen Spitalit Universitar Obstetrik Gjinologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Spitali Universitar Obstetrik Gjinologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë, dhe Universiteti i Mjekësisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama